

UDHËZUESI PËR NOMINIM PËR ÇMIMIN PËR DEMOKRACI

Çmimi për Demokraci nderon nismat e suksesshme, punën dhe aktivitetin e organizatave apo individëve që kanë kontribuar në zhvillimin e shoqërisë demokratike në Kosovë.

Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) fton të gjithë të interesuarit të nominojnë individët apo organizatat për të cilat konsiderojnë se kanë dhënë kontribut të jashtëzakonshëm në demokratizim të vendit.

Çmimi për Demokraci ndahet në kuadër të skemës të granteve për shoqëri civile menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) dhe përkrahur nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida).

Kriteret për nominim

Kush mund të nominohet?

Të drejtën për t'u nominuar e kanë të gjitha e kanë të gjitha organizatat e shoqërisë civile, përfshirë organizatat jo-qeveritare, rrjetet formale dhe jo-formale, mediet jo për përfitim dhe iniciativat qytetare të paregjistrura, si dhe individët të cilët me punën dhe përkushtimin e tyre kanë kontribuar në demokratizimin e shoqërisë kosovare. Organizatat për përfitim/bizneset nuk mund të nominohen.

Kush mund të nominojë?

Nominimet mund t'i paraqesë cilado organizatë, entitet apo person që ka informata të sakta dhe të detajuara mbi *nismën* e organizatës apo individit të nominuar. Të interesuarit mund të nominojnë edhe vetveten.

Kriteret e përzgjedhjes

Të gjitha nominimet do të shqyrtohen veç e veç dhe do të vlerësohen nga një bord i pavarur, bazuar në këto kritere:

- ✓ *Dizajnimi dhe zbatimi i një nisme të suksesshme (qasje, aktivitet, projekt, etj.) në promovimin dhe zhvillimin e demokracisë në Kosovë, gjatë vitit 2019;*
- ✓ *Natyra inovative e nismës;*
- ✓ *Ndikimi aktual ose i prituri i kësaj nisme, duke përfshirë potencialin për zgjerim/përsëritje;*
- ✓ *Guximi i organizatës a individit shprehur përmes nismës në fjalë;*

Çmimi synon të nderojë të gjithë ata/ato që kanë kontribuar në zhvillimin e demokracisë në Kosovë, nga të gjitha fushat, nëpërmjet angazhimit qytetar në nivele të ndryshme të qeverisjes dhe/ose përmirësimit të të drejtave civile, sociale, ekonomike ose kulturore të grupeve të ndryshme të qytetarëve të Kosovës, me theks të veçantë në grupet e marginalizuara.

Përkrahur nga:



Procesi i nominimit

Për të kompletuar procesin e nominimit, sigurohuni që keni plotësuar dhe dorëzuar dokumentet vijuese:

1. Formularin për nominim të plotësuar;
2. Dokumentet përcjellëse (artikuj të shkruar dhe referenca për të nominuarin/en, etj.);
3. Për organizata jo-qeveritare, një kopje të certifikatës së regjistrimit; Për nismat qytetare një dëshmi mbi funksionimin e nismës¹. Për entitetet tjera, një kopje të dokumentit themelues apo të ndonjë dokumenti tjetër të barasvlefshëm. (*Dokumentet duhet të jenë të subjekteve të nominuara, jo të nominuesve*).

Dorëzimi i dokumentacionit

Formulari për nominim së bashku me dokumentet plotësuese duhet të dërgohen në formë elektronike në formatin Word ose PDF në award@kcsfoundation.org jo më vonë se **20 janar 2020**.

Aplikacionet e dorëzuara pas datës 20 janar 2020 nuk do të shqyrtohen.

Ky aplikim nuk parasheh ofrimin e përgjigjeve individuale dhe dhënien e arsytimit për nominimet e papërkrahura. Aplikantët e suksesshëm do të njoftohen për vendimin pas vlerësimit të plotë të nominimit. Gjatë procesit të vlerësimit palët nuk duhet të kontaktojnë KCSF-në mbi statusin e nominimit të tyre.

¹ Çfarëdo dokumenti që dëshmon ekzistencën e nismës p.sh: lista e anëtarëve, foto, materiale nga aktivitetet/takimet etj.

Përkrahur nga: